

VENDIM
Nr. 563, datë 3.7. 2013

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KËRKESAT MINIMALE TË SIGURISË DHE SHËNDETIT PËR PËRDORIMIN E PAJISJEVE MBROJTËSE INDIVIDUALE NË VENDIN E PUNËS”¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 42 të ligjit nr.10 237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

3. Pikat 16.1 deri te 16.5 të aneksit V të vendimit nr. 312, datë 5.5.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier””, që kanë të bëjnë me objektin e kësaj rregulloreje, si dhe të gjitha aktet nënligjore që bien ndesh me këtë rregullore shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

¹ Ky vendim i Këshillit të Ministrave transponon direktivën e BE-së 89/656/EEC, datë 30 nëntor 1989, për kërkesat minimale të shëndetit dhe sigurisë për përdorimin nga punonjësit e pajisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës (direktiva e tretë individuale në kuptim të nenit 16(1) të direktivës 89/391/EEC).